



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1707 Prot.

Tiranë, më 13.12.2021

**LËNDA:** Sugjerime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me Projektligjin “Për krijimin e Regjistrimit Kombëtar për autorët e krimeve seksuale”.

**ZNJ. KLOTILDA BUSHKA**  
**KRYETARE**

**KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT**  
**KUVENDI I SHQIPËRISË**

*Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë*

**Për dijeni:**

**ZNJ. LINDITA NIKOLLA**  
**KRYETARE E KUVENDIT**  
**KUVENDI I SHQIPËRISË**

*Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë*

**Të Nderuar!**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar<sup>1</sup>, dhe në kuadër të ushtrimit prej tij, me statusin e institucionit të pavarur publik:

- ✓ të attributeve që i jepen prej Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, (i ndryshuar), për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ përmbushjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit Nr. 10 221/2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”,

<sup>1</sup>Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020 (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020).

Në vijim të ftesës Tuaj për të dhënë mendim lidhur me projektligjin “Për krijimin e Regjistrin Kombëtar të autorëve për Krime Seksuale”, hartuar nga Linja e Këshillimit të Grave dhe Shoqata të tjera, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashtron në lidhje me Projektligjin, komentet si më poshtë vijon:

**Së pari**, në nenin vijim të nenit 5 ku parashikohet “Parimi i Respektimit të të drejtave”, të parashikohet një nen i posaçëm me titull “Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit”, i formuluar si më poshtë:

*“Të dhënat e këtij regjistri dhe aksesit i publikut në të, duhet të përdoren duke mbajtur parasysh parimin e mosdiskriminimit si për autorët e krimeve seksuale, të afërmit e tyre dhe viktimat e krimeve seksuale”.*

**Së dyti**, në nenin 12 parashikohet “Kohëzgjatja e detyrimeve të Regjistrit”, i cili parashikon mundësinë e daljes nga regjistri të autorëve të krimeve seksuale në përmbushjen e kushteve të parashikuara nga neni 12. Me qëllim mbajtjen parasysh të interesit më të lartë të fëmijës, të parashikohet një pikë 2 në vijim të nenit 12 si më poshtë:

*“ 2. Pavarësisht afateve kohore të parashikuara me sipër, nga regjistri kombëtar i autorëve të krimeve seksuale, nuk do dalin autorët të cilët e kanë ushtruar këtë vepër penale ndaj fëmijëve, gjatë ushtrimit të profesionit të tyre ose duke përfutuar nga profesioni. ”*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kon

